

Fyres Informacionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË

Nr. 579 Akti/ F.Behari

Vlorë, më 05.08.2024

SHPALLJE – PUBLIKE

Bazuar në nenin 140 pika 5 të Kodit të Proçedurës Penale, po ju dërgojmë per shpallje publike vendimin nr. 283, date 3.6.2024 te Gjykatës se Shkallës së Parë te Juridiksionit te Pergjithshem Vlore.

Deftesa e komunkimit Nr. 579 Akti, date 28.06.2024 eshte kthyer nga sherbimi postar me shenimin "Person ka ndryshuar adrese", per te pandehurin Koço Myftari, sipas adresës së cituar në aktet e dosjes:

Adresa: banues në Rusan –Delvine

Një kopje e kësaj shpallje afishohet pranë :

1. Këndit të afishimit të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Faqes elektronike të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. **Bashkise Delvine** , pranë vendbanimit te pandehurit Koço Myftari .
4. Një kopje e kësaj shpallje të kthehet e konfirmuar sipas ligjit.

Nr. 1786 Protokolli

Data e Marrjes 12.08.2024

Vula



SEKRETARE
Malvina BAJRAMI



RR 640 571 515 AA

Nr. 186 Prot.

Datë 12.08.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË

Nr.50198-02652-61-2024 (579) Regj.Themeltar
Data e regjistrimit 24.10.2019
Rishortimi 21.3.2024

Nr. 283 Vendimi
Datë 3.6.2024

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
“PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES PENALE”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTAR: FJORALD BEHARI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Dolores Zemanaj**, sot më datë 3.6.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 579 Regj.Them., që i përket:

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përfaqësuar nga prokurori Erjon Murataj.

I PANDEHUR: Koço Myftari, i biri i Yllit dhe i Luizës, i datëlindjes 4.5.2000, lindur në Sarandë dhe banues në Rusan, Delvinë, me shtetësi shqiptare, mbrojtur në gjykim nga Av. Migjen Xhavara me Nr.Licence 8676 dhe NIPT L871072201A, anëtar i Dhomës së Avokatisë Vlorë, i caktuar kryesisht.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, i parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

VIKTIMA: Jorgo Andruco, i biri i Kleanthit dhe Sofikës, i datëlindjes 24.8.2001, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, në mungesë.

Gjykata, gjatë fazës së verifikimit të prezencës së palëve, pasi vlerësoi aktet e njoftimit të të pandehurit, dëgjoji Prokurorin e çështjes dhe mbrojtësin e të pandehurit të caktuar kryesisht,

VËREN SE:

I. Procedura gjyqësore;

TARIFE MARRË



Më datë 24.10.2019, mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit Nr. 1093, datë 16.10.2019 të gjyqtarit të seancës paraprake, është regjistruar çështja penale Nr. 579 Regj.Themeltar, me objektin, subjektet dhe bazën ligjore të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kjo çështje fillimisht ka qenë në gjykimin e Gjyqtarit Hektor Sinanaj, i cili për shkak të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është në pamundësi të përkohshme për ushtrimin e funksionit pranë kësaj gjykate. Në zbatim të Urdhrit Nr. 125, datë 13.3.2024 të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kjo çështje iu nënshtua rishortimit elektronik.Nga shorti elektronik i datës 21.3.2024, kjo çështje i kaloi për gjykim këtij trupi gjykues.

Gjykata pasi studioi materialet e paraqitura për gjykim, bazuar në nenin 69 të K.Pr.Penale, çmoi se çështja është në juridiksionin gjyqësor. Në bazë të neneve 13, 74 dhe 332 të K.Pr.Penale, kjo çështje është në kompetencën lëndore të kësaj gjykate. Sa i përket kompetencës tokësore, bazuar në nenin 76 të K.Pr.Penale, sa kohë që vepra penale dyshohet se është kryer në territorin e Bashkisë Himarë, kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Gjithashtu, Gjykata në vështrim të neneve 13, 15, 16, 17, 18 të K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundërshtuar edhe nga palët në proces.

Në zbatim të nenit 333 të K.Pr.Penale, Gjykata caktoi seancën gjyqësore më datë 9.5.2023 duke urdhëruar njoftimin e Prokurorit, të pandehurit Koço Myftari, Av. Migjen Xhavera, si dhe viktimës së veprës penale Jorgo Andruco. Njoftimi i tyre u krye nëpërmjet shërbimit postar. Gjatë verifikimit të prezencës së palëve, Gjykata konstatoi se një nga letërthirjet për njoftimin e të pandehurit, është kthyer nga shërbimi postar, me shënimin "Personi vdekur". Sa i përket viktimës së veprës penale, nga letërthirja rezultoi se kishte marrë dijeni për datën dhe orën e seancës. Ndodhur në këto rrethana, Gjykata, pasi dëgjoi Prokurorin e çështjes dhe mbrojtësin e caktuar kryesisht të të pandehurit, vendosi vijimin e gjykimit në mungesë të viktimës së veprës penale Jorgo Andruco, si dhe urdhëroi përcjelljen e një shkrese Zyrës së Gjendjes Civile të fshatit Rusan, Delvinë, Bashkia Sarandë, me qëllim marrjen e një informacioni zyrtar mbi faktin e dyshuar të vdekjes së të pandehurit Koço Myftari. Seanca u shty për më datë 3.6.2024, ora 12:30.

Në seancën e datës 3.6.2024, Gjykata konstatoi faktin se Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Sarandë, me shkresën Nr. 741 Prot., datë 15.5.2024, ka përcjellë zyrtarisht certifikatën e vdekjes së të pandehurit Koço Myftari. Referuar certifikatës së vdekjes së datës 14.5.2024, evidentohet se i pandehuri Koço Myftari, i biri i Yllit dhe i Luizës, i datëlindjes 4.5.2000, ka vdekur më datë 12.6.2023, në Institucion Spitalor Sp.P.A.("O Evangelismos"), Athinë, Greqi. Ndodhur përpara këtij fakti, Gjykata pyeti Prokurorin e çështjes dhe mbrojtësin e të pandehurit, të cilët kërkuan

pushimin e çështjes penale Nr. 579, datë regjistrimi 24.10.2019, me të pandehur shtetasin Koço Myftari, i akuzuar për veprën penale “Mastrimi”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

II. Vlerësimi i Gjykatës;

Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit”*. Ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili subjekt në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga Gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kritereve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar.

Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm në procesin e dhënies së drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledh fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova në drejtim të fajësisë (dhe pafajësisë) së çdo të dyshuari. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për gjykim, neni 387 e vijues i K.Pr.Penale parashikon vendimmarrjen e gjyqtarit pas shqyrtimit të çështjes në themel. Ndër të tjera, neni 387 i K.Pr.Penale, kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.

Neni 328 i K.Pr.Penale parashikon shprehimisht se: *“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:*

- a) del qartë se fakti nuk ekziston;*
- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;*

- c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;
- ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;
- d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;
- e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;
- ë) i pandehuri vdes;**
- f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj... ”.

Referuar nenit 47/1 të K.Pr.Penale, vdekja e të pandehurit përbën shkak që organi procedues, në çdo gjendje e shkallë të procedimit, të vendos pushimin e çështjes. I njëjti parashikim është përcaktuar edhe në nenin 387 të K.Pr.Penale. Sa i përket momentit procedural të vendimmarrjes së gjykatës, për vetë natyrën e gjykimit penal, Gjykata çmon se, në rastin kur i pandehuri vdes pas përcjelljes në gjykatë të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq ose nisjes së gjykimit të çështjes në themel, por përpara hapjes së hetimit gjyqësor (si në rastin konkret), pushimi i çështjes apo akuzës si një vendim jopërfundimtar, duhet të merret që në momentin e konstatimit të faktit, qoftë edhe në fazën fillestare të procesit. Gjykata nuk mund të vijojë me gjykimin në themel të çështjes sa kohë ka rënë në dijeni se i pandehuri ka ndërruar jetë gjatë procesit. Ky detyrim buron nga neni 47/1 i K.Pr.Penale, i cili parashikon se kur rezulton vdekja e të pandehurit, organi procedues, në çdo gjendje e shkallë të procedimit, vendos pushimin e çështjes penale.

Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se, në kushtet kur provohet se i pandehuri Koço Myftari i biri i Yllit dhe i Luizës, i datëlindjes 4.5.2000, ka vdekur më datë 12.6.2023, në Institucion Spitalor Sp.P.A.(“O Evangelismos”), Athinë, Greqi, çështja penale Nr. 579, datë regjistrimi 24.10.2019, në ngarkim të të pandehurit Koço Myftari, i akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, duhet të pushohet sipas parashikimeve të neneve 328/1 germa ë) dhe 387 të K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 13, 112, 47/1, 328, pika 1, germa ë) dhe 387 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Pushimin e çështjes penale Nr. 579, datë regjistrimi 24.10.2019, në ngarkim të të pandehurit Koço Myftari, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

2. Shpenzimet në fazën e hetimit dhe ato gjyqësore siç janë kryer.
 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.
- U shpall sot në Vlorë, më datë 3.6.2024.**

SEKRETARE

Dolores ZEMANAJ



GJYQTAR

Fjorald BEHARI